



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:067085

Datë: 09.09.2024

Numri i dokumentit: 06139105

CA.nr.9354/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Frosina Sylejmani, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve – propozuesve të sigurimit D.K., P.K., N.K. dhe S.K., që të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson E.Q., avokat në Prizren, kundër të paditurit – kundërshtarit të sigurimit A.T., nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Xh.E., avokat në Prizren, me objekt kontesti vërtetimi i të drejtës së pronësisë, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësve – propozuesve të sigurimit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1226/2024, të datës 26.06.2024, në seancë e kolegjit të mbajtur me datë 06.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET pjesërisht e pathemeltë ankesa e paditësve – propozuesve të sigurimit D.K., P.K., N.K. dhe S.K., që të gjithë nga Prizreni, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1226/2024, i datës 26.06.2024, në pikën I të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

II. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e paditësve – propozuesve të sigurimit D.K., P.K., N.K. dhe S.K., ashtu që **ANULOHET** pika II e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1226/2024, të datës 26.06.2024.

III. Pika III e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1226/2024, të datës 26.06.2024, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar C.nr.1226/2024, të datës 26.06.2024, ka vendosur si në vijim: “ I. REFUZOHET i pabazuar propozimi i paditësve- propozuesve të sigurimit: D.K., P.K., N.K. dhe S.K., që të gjithë nga Prizreni, për caktimin e masës së sigurimit, me të cilin ka kërkuar që të “ndalohet i padituri-kundërshtari i sigurimit A.T. nga Prizreni, që të kryejë aktivitete të caktuara, si vazhdimi i ndërtimit të objektit banesor të deklaruar përmes pëlqimit noterial LRP.nr.20597/2023 i datës

09.11.2023, pranë noterit B.M., sipas të cilit ngastra kadastrale P-..., me sipërfaqe prej 499 m², në vendin e quajtur "A." ZK Prizren, do t'i jepet Komunës së Prizrenit, pasi që ngastra e lartcekur do të shfrytëzohet si hapësirë shoqërore- rrugë kalim dhe do të shfrytëzohet për bonuese për investitorin A.C.E. g., me seli në Prishtinë rr. "... " nr..., Prizren, si dhe të ndërprejë të gjitha veprimet tjera deri në përfundim të këtij kontesti dhe ndalimi të evidentohet në regjistrin publik të paluajtshmërive" II. DETYROHEN paditësit- propozuesit e sigurimit, që në mënyrë solidare, në emër të shpenzimeve të procedurës për caktimin e masës së sigurimit, të paditurit-kundërshtarit të sigurimit, t'ia paguaj shumën prej 780.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm; III. Procedura në këtë çështje juridike - kontestimore do të vazhdojë sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës".

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor kanë ushtruar ankesë paditësit – propozuesit e sigurimit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë si të bazuar ankesën e paditësve-propozuesve dhe ta ndryshoj aktvendimi e atakuar sa i përket refuzimit të propozimit për caktimin e masës së sigurimit dhe detyrimit për shpenzimet procedurale.

Kundërshtari i sigurimit përmes përfaqësuesit të autorizuar ka paraqitur përgjigje në ankesën e propozuesve të sigurimit, përmes të cilës ka propozuar që Gjykata e Apelit ankesën e propozuesve ta hedh poshtë si të pabazuar dhe ta vërtetojë aktvendimin e atakuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 lidhur me nenin 208 dhe 209 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e propozuesve të sigurimit është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit - propozuesit e sigurimit, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 28.02.2024, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi kundër të paditurit - kundërshtarit të sigurimit, për vërtetimin e pronësisë me propozim për caktimin e masës së sigurimit, ndërsa në seancën gjyqësore të datës 26.06.2024, kanë bërë precizimin e propozimit për caktimin e masës së sigurimit. Në propozimin për caktimin e masës së sigurimit propozuesit kanë theksuar se në vitin 2023 kanë kuptuar se është projektuar ndërtimi i objekteve banesore ku përfshihet edhe ngastra nr..., të cilën propozuesit e sigurimi pretendojnë se e kanë blerë në vitin 2001 dhe lidhur me këtë i kishin njoftuar edhe investitorët. Tutje, propozuesit e sigurimit kanë theksuar se ngastrën kadastrale kontestuese e kishin blerë nga kundërshtari i sigurimit, përmes kontratës së shitblerjes dhe për të njëjtën kanë paguar 28,000.00 DM, andaj kanë kërkuar nga i padituri njohjen e të drejtës së pronësisë mbi këtë bazë, mirëpo nuk ka pasur sukses. Duke qenë se në ngastrën kontestuese vetëm se ka filluar ndërtimi i objekteve banesore, propozuesit e sigurimit konsiderojnë se ekziston rreziku që pa caktimin e masës së sigurisë, 70% e objektit banesor do të i takojë investitorit, duke pamundësuar kështu vërtetimin e pronësisë dhe realizimin e kërkesëpadisë. Prandaj, i kanë propozuar gjykatës që ta caktojë masën e sigurimit në ngastrën kontestuese si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. I padituri – kundërshtari i sigurimit e ka kundërshtuar në tërësi propozimin për caktimin e masës së sigurimit, pasi që i

njëjti është i pabazuar dhe me asnjë provë nuk vërtetohet e drejta e tyre, andaj ka propozuar që propozimi i paditësve – propozuesve për caktimin e masës së sigurimit, të refuzohet në tërësi si i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas propozimit të palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit, ka marrë aktvendimin e atakuar, C.nr.1226/2024, të datës 26.06.2024, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar propozimin për caktimin e masës së sigurimit, me përmbajtje sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetim të këtij aktvendimi gjykata ka theksuar se pas shqyrtimit të propozimit, deklarimit të palëve dhe analizimit dhe vlerësimit të provave ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit është i pabazuar. Sipas konstatimit të gjykatës, duke iu referuar kushteve për caktimin e masës së sigurimit të përcaktuara me nenin 297 par.1 të LPK-së, paditësit – propozuesit e sigurimit deri në këtë fazë të procedurës nuk e kanë bërë të besueshme kërkesën e tyre apo të drejtën subjektive. Kjo sepse deklaratimet e paditësve – propozuesve të sigurimit janë kontradiktore ndërmjet vete dhe me provat e administruara, përkatësisht deklaratimet sa i përket autorizimit verbal të paditësve – propozuesve të tjerë për paditurve – kundër propozuesve, sa i përket autorizimit të av. V.H. nga ana e të paditurve – kundër propozuesve, sa i përket lidhjes së kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, e datës 03.08.2001. Tutje, gjykata ka theksuar se nuk është vërtetuar që kjo kontratë është nënshkruar në mënyrë legjitime, prandaj përmes saj nuk mund të provohet e drejta subjektive e paditësve – propozuesve. Ndërkaq, sa i përket pretendimit se i padituri – kundërshtari i sigurimit dhe familjarët e tij kanë pranuar nga paditësit – propozuesit e sigurimit shumë prej 28,000.00 DM në emër të shitblerjes së ngastrës kadastrale, gjykata e vlerësoi si të pa provuar me prova dhe theksoi se një fakt i tillë i përket më shumë shqyrtimit dhe vlerësimi të çështjes meritorë, sesa propozimit për caktimin e masës së sigurisë. Sa i përket ekzistimit të rrezikut real, gjykata vlerësoi se në rastin konkret i njëjti nuk është real për shkak se propozuesit e sigurimit nuk kanë arritur të e bëjnë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive, andaj meqë pa përmbushjen e kushtit të parë nuk mund të vie në shprehje caktimi i masës së sigurimit, gjykata vendosi si në dispozitivin e aktvendimi të atakuar. Vendimin për shpenzimet procedurale gjykata e mbështeti në nenin 449, 452 par.1 dh e 453 par.2 të LPK-së lidhur me nenin 137 të po të njëjtit ligj.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala paditëse me ankesë, përveç pjesës ku është vendosur për shpenzimet e procedurës për çka aktvendimi në këtë pjesë është dashur që të anulohet.

Janë të pabazuara pretendimet ankimore të propozuesve të sigurimit se aktvendimi i atakuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të mjaftuar për faktin

vendimtar rreth plotësimit të kushteve ligjore për caktimin e masës së sigurimit, dhe në këtë drejtim aktvendimi në fjalë nuk është kundërthënës me përmbajtjen e dokumenteve dhe provave të paraqitura ashtu siç theksohet në ankesë.

Gjykata e Apelit në tersi mbështet vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket çështjes së vlerësimit të plotësimit të kushteve në mënyre kumulative për caktimin e masës së sigurisë, ashtu siç është përcaktuar më nenin 297 paragrafi 1, pika (a) dhe (b) të LPK-së, sipas së cilës *“Masa e sigurimit mund të caktohet: në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtrillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Kolegji pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë së propozuesit e sigurimit deri në këtë fazë të procedurës nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive, duke marrë parasysh faktin së propozuesit e sigurimit padinë e kanë orientuar dhe vërtetimin e pronësisë në ngastrën në të cilën kanë kërkuar që të caktohet masa e sigurimit e kanë kërkuar mbi bazën e kontratës së shitblerjes të datës 03.08.2021. Në bazë të kontratës së shitblerjes të datës 03.08.2001, rezulton së kjo kontratë është lidhur në mes të trashëgimtarëve të ndjerit H.T., në mesin e të cilëve edhe këtu kundërshtarit të sigurimit në cilësi të shitësve, dhe propozuesve të sigurimit të cilësi të blerësve, ku sipas kësaj kontrate këtu propozuesit kishin blerë një pjesë të ngastrës kadastrale ..., në vendin e quajtur “A.”, ZK Prizren, në vlerë prej 28.000 DM, ndërsa në bazë të historiatit të dhënë nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, Komuna e Prizrenit, datë 17.04.2024, rezulton së kjo ngastër në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes ka qenë e evidentuar në emër të H.T., e cila me vonë në bazë të aktvendimit të trashëgimisë T.nr.107/05, të datës 30.12.2013, të Gjykatës Themelore në Prizren, pra ngastra ..., ZK Prizren, në sipërfaqe prej 13482 m², ka kaluar të trashëgimtarët e H.T., me nga 1/9 pjesë ideale, dhe në bazë të ujdisë gjyqësore CN.nr.520/18, datë 23.05.2019, të vërtetuar në Gjykatën Themelore në Prizren, është bërë ndarja fizike e njësisë kadastrale ..., në katër pjesë, dhe pjesa e ngastrës të cilën propozuesit pretendojnë që e kanë blerë, pas ndarjes ka marrë numrin ..., në sipërfaqe prej 499 m², dhe ka kaluar në emër të kundërshtarit të sigurimit A.T., e cila sipas gjendjes faktike është duke u shfrytëzuar si rrugë nëpër të cilën kalojnë propozuesit dhe personat të tjerë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, fakti nëse personat që e kanë nënshkruar këtë kontratë kanë pasur autorizim dhe nëse është paguar çmimi i shitblerjes janë rrethana të cilat duhet të provohen me rastin e shqyrtimit të kërkesëpadisë, megjithatë ekzistimi i kërkesës apo të drejtës subjektive si kusht për caktimin e masës duhet të vlerësohet në kuadër të kërkesës kryesor pasi që e njëjta nuk mund të interpretohet krejt shkëputur nga kërkesa kryesore që kërkohet që të sigurohet me masë, andaj duke marrë parasysh faktin së këtu propozuesit me kërkesën kryesore kanë kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi bazën e kontratës së shitblerjes të datës 03.08.2021, e cila nuk është kontestuese së nuk vërtetuar të organi kompetent, gjykata vlerëson së propozuesit e sigurimit deri në këtë fazë të procedurës nuk e kanë bërë të besueshëm ekzistimin e kërkesës apo të drejtën subjektive dhe pa plotësimin e këtij kushti nuk mund të

caktohet masa e sigurimit. Për me tepër, me propozim për caktimin e masës së sigurimit ashtu siç është precizuar, preken edhe të drejtat e personave të tretë të cilët nuk janë palë të përfshirë në këtë procedurë, pasi që me masë të sigurimit është kërkuar që kundërshtarit të sigurimit t'i ndalohej aktivitetet të caktuar si vazhdimi i ndërtimit të objektit banesor, edhe pse në bazë të këqyrjes në vend me ekspertin e gjeodezisë, gjykata ka konstatuar se punimet janë duke u kryer në ngastrën fqinjë ..., dhe jo në ngastrën në të cilën është kërkuar që të caktohet masa e sigurimit, dhe së në këtë rast investitori (kryesi i punimeve) nuk është kundërshtari i sigurimit por person i tretë.

Gjykata e Apelit, pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë së pa ekzistimin apo përmbushjen e kushtit të parë nuk mund të vije në shprehje kushti i dytë, ekzistimi i rrezikut, dhe në mungesë të plotësisht të kushtit të parë që është besueshmëria e ekzistimit të së drejtës subjektive nuk mund të caktohet masa e sigurimit pasi që këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative. Andaj, nga këto arsye kjo gjykatë vlerëson se nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për caktimin e masës së sigurimit, ashtu siç është përcaktuar me nenin 297 paragrafi 1, pika (a) dhe (b) të LPK-së.

Gjykata e Apelit pa u lëshuar në shpjegime të mëtejme të cilat mund të prejjudikojnë vendosjen meritorë për themelësinë e kërkesëpadisë, jep vlerësimin se aktvendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, por fakti se me aktvendimin e atakuar është refuzuar masa e sigurimit të kërkesëpadisë nuk nënkupton se vendosja meritorë nuk mund të jetë ndryshe, pasi që vendosja meritorë është rezultat i të gjeturave të gjykatës në shqyrtim kryesor, ku shqyrtohen të gjitha faktet dhe provat për të gjitha kërkesat/pretendimet dhe kundërshtimet.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, ashtu që ka anuluar pikën II e dispozitivit të aktvendimit të atakuar ku është vendosur për detyrimin e propozuesve që kundërshtarit të sigurimit t'ia paguajnë shpenzimet e procedurës, pasi që gjeti si të bazuar pretendimin ankimor të propozuesve së gjykata për shpenzimet e procedurës do të duhej të vendoste sipas aktgjykimit kur të shqyrtohet kërkesëpadia e paditësve. Kjo për faktin së sipas nenit 463 paragrafi 4 të LPK-së është paraparë së *“Për kërkesën e palës për pagimin e shpenzimeve të procedurës, gjykata do të vendos në aktgjykimin ose aktvendimin me të cilin përfundon procedura përpara kësaj gjykate”*. Ndërsa në bazë të nenit 314 paragrafi 2 të LPK-së është paraparë së *“Po që se propozimi për caktimin e masës së sigurimit paraqitet gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore apo të ndonjë procedure tjetër gjyqësore, gjykata kompetente për vendosje mbi kërkesëpadinë, apo mbi kërkesën tjetër, vendosë se cili i bartë shpenzimet e caktimit dhe zbatimit të masës së sigurimit”*. Bazuar në këto dispozita kjo gjykatë vlerëson së gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që të vendos për shpenzimet e procedurës pasi që me aktvendimin që gjykata vendos sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit nuk përfundon procedura para gjykatës së shkallës së parë, sepse një propozim i tillë mund të përsëritet nga pala që ka interes në rast së ndryshojnë rrethanat prej momentit të vendosjes, andaj gjykata e shkallës së parë për shpenzimet e procedurës duke përfshirë edhe shpenzimet e shkaktuar gjatë trajtimit të propozimit për caktimin e masës së sigurimit duhet të vendos me rastin e vendosjes së çështjes kryesore mbi kërkesëpadinë dhe varësisht nga sukcesi i palëve në procedurë.

Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar aktvendimin e atakuar në pikën III të dispozitivit, pasi që nuk kishte pretendime ankimore në këtë pjesë sipas të cilës gjykata ka vendosur që procedura në këtë çështje juridike - kontestimore do të vazhdoj sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të punës së gjykatës.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 208 dhe 209 pika (b) dhe (d) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.9354/2024, datë 06.09.2024

Kryetari i kolegjit – Gjyqtari
Hysni Bardheci